



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORI I PERGJITHSHEM**

UDHËZIM

**Nr. 2 Datë 26. 06. 2002
PER Zbatimin e ligjit "Për Dhënie Amnistie"**

Me synim, pëgashtimin nga ndjekja penale në hetimet paraprake dhe në gjyq, si dhe mosekzekutimin e vendimeve penale ndaj personave që përfitojnë nga kjo amnisti;

Meshtetur, në nenin 8 pika 2 të Jigjit Nr. 8737 datë 12, 02. 2001 "Per oiganizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë * cHe në nenin 5 të ligjit Nr. 8895 datë 16. 05. 2002 *Për dhenie Amnistie",

U D H E Z O J:

- 1. NË PAZËN E HETIMEVE PARAPRAKE,** për vepra penale të kryera deri me datën 1 qeshor 2002, për të cilat Kodi Penal dhe Kodi Penal UshtaraJc parashikon dënim me burgim deri ne 2 vjet ose çdo ttoj dënirai më'të butë, prokurorët sipas juridiksionit dhe kompetences, duhet të vendosin:
 - 1.1. Mosfillimin e procedimeve, mbështetur në nenet 291 pika 1 dhe 290 pika 1 shkronja "dh" të K. Pr. Penale, vetëm për të gjithë kallzimet ose ankimet e regjistruara, deri me date 1. 06. 2002, ne Prokurori ose në seksione/shërbime të Policisë Gjyqësore të cdo strukture.
 - 1.2. Pushimin e çështjeve, mbështetur në nenet 328 pika 1 shkronja T dhe 290 pika 1 shkronja "dh" të K. Pr. Penale, për të gjithë procediraet penale në fazën e hetimeve paraprake të regjistruara në Prokurori, deri me datë 1. 06. 2002.
 - Kjo zgjidhje ligjore duhet t'iu jepet edhe procedimeve penale që janë pezulluar hetimet, për vepra penale që përfitojnë nga kjo amnisti, duke vendosur më parë rifillimin e hetimeve të pezulluara, mbështetur ne nenin 326 pika 3 e K. Pr. Penale.

1.3, Vendimet e mosfillimit të procedimeve dhe të pushimit të çështjeve t'i njoftohen të interesuarve, për t'iu garantuar të drejtën ligjore të ankimit në gjykatë.

- Ato që kanë pësuar dëm materjai nga vepra penale që amnistohet, të sqarohen për të drejtën e ngritjes së padis civile në gjykatë.

1.4. Në rastet, kur në aktet e kallzimit, ngjarjes ose ankimit, apo në aktet e hetimeve paraprake në ndjekje, nuk mund të konkludohet për kualifikimiri Hgjor, nëse ndodhemi ose jo para veprës penale të amnistuar, duhet të" kryhen hetime të nevojshme, për të provuar faktin dhe pasi te bëhet kualifikimi i drejtë i veprës penale, të vendoset për mënyrën e zgjidhjes ligjore të përfundimit të çështjes.

2. **NE FAZEN E GJYKIMIT**, për akuzat e ngritura dhe të pashqyrtuara nga gjykata, për vepra penale të kryera deri me datën 1 qeshor 2002, për të cilat Kodi Penal dhe Kodi Penal Ushtarak parashikon dënim me burgim deri ne 2 yjet ose çdo lloj dënimi më të butë, prokurorët sipas juridiksionit dhe kompetences, duhet të marrin pjesë në shqyrtimin gjyqësor të këtyre çështjeve dhe të kërkojnë nga gjykata, pushimin e çështjeve.

2.1. Në rastet e shqyrtimit të çështjeve mbi ankim ose rekurs, për vepra penale që nuk janë amnistuar, për shkak të kualifikimit të gabitar ligjorë të bërë nga gjykata e shkallës më të ulët, e cila dokie ndryshuar kualifikimin dhe ka dënuar përsonein për vepra penale që amnistohen, prokurorët pranë gjykatave përkatëse, të mbajnë qëndrimin e duhur ligjor në shqyrtimin gjyqësor të këtyre çështjeve, duke argumentuar në konkluzionet përfundimtare, kualifikimin e drejtë të veprës penale të kryer nga i akuzuari dhe duke i kërkuar gjykatës zgjidhjen e drejtë ligjore të çështjes.

3. **NE FAZEN E EKZEKUTIMIT TE VENDIMEVE PENALE**, prokurorët, prantë Gjykatave të shkallës së parë që ka dhënë vendimin, të verifikojn-ë urdhërat e tyre të ekzekutimit të pazbatuara, për të gjithë kategoritë e përsoneve dhe Uojet e denimit që përfitojnë sipas nenit 1 pikat 1 e 2 të këtij ligji, duke urdhëruar mosekzekutimin e tyre, bazuar në lëtë amnisti.

4. Drejtuesit e Prokurorive pranë Gjykatave të shkallës së parë dhe Gjykatave të Apelit, mbrenda datës 30 korrik 2002, të informqn-ë zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm, për numrin e përsoneve dhç t ë procedimeve të* mosfilluara, çështjeve të pushuara në hetimest paraprake dhe në gjyq, si dhe për numrin e përsoneve të dënuar në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale, që kanë përfituar nga kjo amnisti.

- 5, Për të ndjekur dhe kontrolluar zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen drejtuesit e strukturës të zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm.
6. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë, ndërsa zbatimi i tij, për efekt të hyrjes në fuqi të ligjit, fillon me datë 30. 06. 2002.

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

THEODHORI SOLLAKU

L I G J

Nr. 8895, datë 16.5.2002

PËR DHËNIE AMNISTIE

Në mbështetje të neneve 81 pika 1, pika 2. shkronja "ë" dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozirain e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBUKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

1. Amnistohen personat e dënuar me burgim deri në 2 vjet, personat e dënuar me kusht ose megjohë.

2. Amnistohen personat e dënuar me burgim, të cilët në" kohen e kryerjes së' veprës penale kanë qenë nen mosbin 18 vjeç, femrat që në datën 1 qershor 2002 kanë mbushur moshën 55 vjeç dhe meshkujt që kanë mbushur moshën 65 vjeç,

3. Amnistohen personat e dënuar me burgim ose me dënime më të buta, të cilëve ne datën i qershor 2002 u ka mbetur pa vuajtur nga ky dënim deri në 2 yjet.

4. U zbriten 1/4 (përsëritësve të së njëjtës veprë penale u zbriten 1/8) e dënimit të mbetur të gjithë të dënuarve, të cilët nuk përfitojnë nga pikat e mësipërme të këtij neni,

Neni2

1 Nuk përfitojnë nga kjo amnisti personat e dënuar për:

a) veprat penale të parashikuara nga nenet 76, 77, 78, 79 të Kodit Penal dhe neni 77 i Kodit Penal Ushtarak;

b) veprat penale të parashikuara nga nenet 100, 101 pika 2, 102, 103 dhe 104 të Kodit Penal;

c) rrëmbim personi i parashikuar në nenin 109 të Kodit Penal;

ç) trafikim të njerëzve, shfrytëzim prostitucioni, shfrytëzim prostitucioni në rreihana rënduese, trafikim të femrave për prostitucion, të parashikuara nga nenet 110 shkronja "a", 114, 114 shkronja "a" dhe 114 shkronja "b" të Kodit Penal;

d) veprat penale të parashikuara nga nenet 136, 139, 140 dhe 141 të Kodit Penal, si dhe për vjedhje të pronës ushtarake me pasojë vdekjen e parashikuar nga neni 59 pika 2 i Kodit Penal Ushtarak;

dh) gjenocid, krime kundër njerëzimit dhe krime lufte të parashikuara nga nenet 73, 74 dhe 75 të Kodit Penal;

e) tortura me pasoja të rënda të parashikuara nga neni 87 i Kodit Penal;

ë) krime kundër pavarësisë dhe integritetit të parashikuara nga nenet 208, 209, 210, 211, 212, 217 dhe 218 të Kodit Penal;

f) krime kundër rendit kushtetues të parashikuara nga nenet 219, 220 dhe 221 të Kodit Penal.

g) krime që cenojnë marrëdhëniet me shtetet e tjera, të parashikuara nga nenet 226, 227, 228 dhe 229 të Kodit Penal;

gj) akte terroriste të parashikura nga nenet 230 dhe 232 të Kodit Penal;

h) trafikim të armëve dhe municionit të parashikuara nga neni 278 shkronja "a" i Kodit Penal;

i) trafikim të lëndëve plasëse, djegëse, helmuese dhe narkotike të parashikuara nga nenet 283, 284, 284 shkronja "a", 284 shkronja *V\ 286 pika 2 të Kodit Penal;

Neni 3

Për efekt të zbatimit të këtij ligji, do të quhen të dënuar:

a) personat e dënuar nga gjykata e shkallës së parë dhe, që brenda afatit ligjor nuk është bërë ankim ose apel në gjykatën e apelit;

b) personat e dënuar nga gjykata e apelit.

Neni 4

Pushohen ndjekjet penale për çështjet në hetim, për çështjet e pashqyrtuara nga gjykatat, si dhe për kallëzimet që ndodhen në këto organe dhe në organet e rendit pubtik, për veprat penale të kryera deri në datën 1 qershor 2002, për të cilat Kodi Penal parashikon një dënim me burgim deri në 2 vjet ose çdo lloj dënimi tjetër më të butë.

Neni 5

Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Rendit Publik, Ministria e Mbrojtjes dhe Prokuroria e Përgjithshme për zbatimin e këtij ligji.

Neni 6

Ky ligj liyn në ruqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.